

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SUHAREKË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **624-26-6459-5-2-1**

Sa i përket tenderit për **Projekt me bashkfinancim - Rikonstruimi i shtresës së asfaltit të rrugës që lidh fshatrat Reshtan-Semetisht-Breshac dhe Nishor**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj	SEFERI-CO SH.P.K.
NUI	810100537
Adresa	Gjinoc-Suharekë
Vendi	Suharekë
Kodi postar	23000
Numri Telefonit	
Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj	Bujar Seferaj
Adresa elektronike	sefericompany@gmail.com
Data e parashtrimit të ankesës	02.09.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit
Adresa e plotë
Numri i Telefonit
Numri i faks-it
Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Projekt me bashkfinancim - Rikonstruimi i shtresës së asfaltit të rruges që lidh fshatrat Reshtan-Semetisht-Breshac dhe Nishor

Kerkese per sqarim 24.08.2026

Sqarimi:26.08.2026

Kerkese per rishqyrtim 27.08.2026 ora 10:18

Vendim i refuzimit te kerkeses per rishqyrtim:27.08.2026 16:04

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐

Jo ☒

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se.

Kerkese per sqarim 24.08.2026

Sqarimi:26.08.2026

Kerkese per rishqyrtim 27.08.2026 ora 10:18

Vendim i refuzimit te kerkeses per rishqyrtim:27.08.2026 16:04

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Nenin 7 të LPP-së, lidhur me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe detyrimin që aktiviteti të mos zhvillohet në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën;

Nenin 28 të LPP-së, lidhur me hartimin e specifikimeve në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe qasjen sa më të mirë për operatorët ekonomikë;

Nenin 51 të LPP-së, lidhur me detyrimin që kriteret të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme dhe të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale;

Nenin 53 të LPP-së, lidhur me sqarimet dhe informatat që ndikojnë në përgatitjen e ofertës;

Nenin 69 të LPP-së, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale;

Nenin 108/A paragrafët 6 dhe 9 të LPP-së, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe detyrimin që refuzimi të jetë i arsyetuar;

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Referoju ankesit 1

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Ne kete faze nuk ka deme matriale

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

ANKESË

Drejtuar:

ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT – OSHP

Kundër:

AUTORITETIT KONTRAKTUES – KOMUNA E SUHAREKËS

Parashtruesi:

SEFERI-CO SH.PK.

Aktiviteti i prokurimit:

“Projekt me bashkëfinancim – Rikonstruimi i shtresës së asfaltit të rrugës që lidh fshatrat Reshtan, Semetisht, Breshac dhe Nishor”

Nr. i prokurimit: 624-26-6459-5-2-1

Nr. i brendshëm: 624-26-49-521

Lënda: Ankesë kundër Vendimit të Autoritetit Kontraktues të datës 27.08.2026 për refuzimin e Kërkesës për Rishqyrtim të OE “SEFERI-CO” SH.PK.

HYRJE

Operatori Ekonomik SEFERI-CO SH.PK., si palë e interesuar në aktivitetin e lartcekur të prokurimit, paraqet këtë ankesë kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues – Komuna e Suharekës, përmes të cilit është refuzuar Kërkesa jonë për Rishqyrtim.

Më datë 24.08.2026 kemi parashtruar kërkesë për sqarim lidhur me një numër të konsiderueshëm kriteresh të Dosjes së Tenderit, ndërsa AK ka publikuar përgjigjen më 26.08.2026. Pas analizimit të përgjigjeve dhe konstatimit se një pjesë e konsiderueshme e pyetjeve nuk ishin trajtuar në mënyrë konkrete, më 27.08.2026 kemi parashtruar Kërkesën për Rishqyrtim.

Kërkesa për Rishqyrtim ka qenë e detajuar dhe ka trajtuar në mënyrë individuale kriteret e kontestuara, duke kërkuar konkretisht nga AK identifikimin e pozicionit të paramasës, sasisë së punimeve, bazës teknike dhe arsyes së parametrave të përcaktuar.

Përkundër kësaj, konsiderojmë se vendimi për refuzimin e kërkesës nuk përmban një shqyrtim merit të pretendimeve dhe nuk e adreson çështjen themelore të ngritur nga OE: nevojshmërinë, relevancën dhe proporcionalitetin konkret të kriterëve të përcaktuara nga AK.

KOHA JASHTËZAKONISHT E SHKURTËR E SHQYRTIMIT TË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM DHE MUNGESA E NJË VLERËSIMI MERITOR

Një rrethanë me rëndësi të veçantë për vlerësimin e mënyrës se si është trajtuar Kërkesa për Rishqyrtim është kronologjia e vendimmarrjes së AK-së.

OE SEFERI-CO SH.P.K. e ka dorëzuar Kërkesën për Rishqyrtim më:

27.08.2026, ora 10:24

ndërsa AK e ka publikuar vendimin për refuzimin e saj po më:

27.08.2026, ora 16:05.

Pra, nga momenti i dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim deri në nxjerrjen dhe publikimin e vendimit kanë kaluar vetëm:

5 orë e 41 minuta.

Vetë formulari i kërkesës konfirmon se ajo është parashtruar më 27.08.2026.

Nuk pretendojmë se AK ka qenë e obliguar të presë kalimin e tërë afatit ligjor për të nxjerrë vendimin. Megjithatë, sipas nenit 108/A paragrafi 6 të LPP-së, AK duhet ta shqyrtojë Kërkesën për Rishqyrtim brenda tre ditëve të punës, ndërsa në raste të justifikuara ky afat mund të zgjatet edhe për tri ditë shtesë.

Termi ligjor “shqyrtojë kërkesën” nuk duhet të kuptohet vetëm si nxjerrje formale e një vendimi, por si analizim real i pretendimeve, dokumentacionit dhe rrethanave që janë ngritur nga pala.

Në rastin konkret nuk kemi pasur një pretendim të vetëm apo një çështje të thjeshtë formale.

Kërkesa për Rishqyrtim përmbante një numër të konsiderueshëm pretendimesh për:

kriteret e stafit profesional;

proporcionalitetin e viteve të përvojës;

kriteret teknike për pajisjet;

kufijtë minimalë dhe maksimalë të peshës;

kërkesat për teknologji të veçanta;

ekuivalencën teknike;

ndërlidhjen e kritereve me paramasën;

si dhe sqarimet materiale të dhëna nga AK pas publikimit të Dosjes së Tenderit.

Për pothuajse çdo kriter është kërkuar një analizë sipas:

POZICIONIT TË PARAMASËS → SASISË SË PUNËS → NEVOJËS TEKNIKE → KRITERIT →
PARAMETRIT TË KËRKUAR.

Për të refuzuar në mënyrë meritore një kërkesë të tillë, AK është dashur të bëjë ballafaqimin e pretendimeve me:

projektin, paramasën, sasitë, specifikimet teknike dhe bazën mbi të cilën Njësia e Kërkesës kishte përcaktuar kriteret.

Në këto rrethana, fakti që një kërkesë kaq voluminoze është trajtuar dhe refuzuar brenda vetëm 5 orë e 41 minuta, ndërsa arsyetimi i vendimit mbetet kryesisht në nivel të përgjithshëm, krijon dyshim serioz se pretendimet nuk janë analizuar në thellësinë e kërkuar.

Ky konstatim përforcohet edhe nga neni 108/A paragrafi 9 i LPP-së, i cili kërkon që refuzimi i Kërkesës për Rishqyrtim të jetë i arsyetuar dhe t'i komunikohet me shkrim parashtruesit.

Arsyetimi nuk nënkupton vetëm ekzistencën e një teksti formal në vendim.

Për një pretendim konkret, duhet të mund të kuptohet:

çfarë është pretenduar → çfarë ka verifikuar AK → mbi cilat të dhëna është mbështetur → dhe pse pretendimi është refuzuar.

Në rastin konkret ky ballafaqim mungon në një pjesë të konsiderueshme të pretendimeve.

Prandaj, vetë fakti që vendimi është nxjerrë brenda afatit maksimal ligjor nuk mjafton. Çështja që duhet vlerësuar është nëse brenda asaj kohe është kryer shqyrtim real dhe meritore, dhe jo vetëm përfundimi formal i procedurës paraprake.

I AK E KA ZHVENDOSUR NË MËNYRË TË GABUAR BARRËN E ARGUMENTIMIT TE OPERATORI EKONOMIK

Në arsyetimin e vendimit, AK thekson se OE nuk ka paraqitur:

prova konkrete;

analiza teknike;

të dhëna të tregut;

dokumentacion tjetër që dëshmon favorizimin e një operatori;

apo prova se kriteret mund të përmbushen vetëm nga një prodhues.

Konsiderojmë se ky arsyetim nuk e adreson thelbin e pretendimeve tona dhe e zhvendos diskutimin drejt një standardi tjetër nga ai që kemi ngritur.

Pretendimi ynë kryesor nuk ka qenë se kriteri është përgatitur për një kompani të identifikuar apo për një prodhues të caktuar.

Pretendimi është se AK duhet të jetë në gjendje të demonstrojë se kriteret e përcaktuara prej saj janë:

të nevojshme, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.

Kjo kërkesë nuk buron nga preferenca e OE-së.

Ajo buron drejtpërdrejt nga neni 51 i LPP-së.

Neni 51.1 përcakton se kriteret e përzgjedhjes duhet të kufizohen vetëm në kriteret e nevojshme për të siguruar aftësinë profesionale, financiare dhe teknike, ndërsa paragrafi 3 përcakton se të gjitha kriteret duhet të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale me lëndën e kontratës.

Prandaj standardi ligjor nuk është vetëm:

“A ka kriteri ndonjë lidhje me kontratën?”

por:

“A është kriteri i nevojshëm?”

“A është drejtpërdrejt relevant?”

“A është niveli i tij proporcional?”

Një pajisje mund të ketë lidhje me procesin e realizimit të punimeve dhe megjithatë parametri specifik i saj të jetë më kufizues sesa nevoja reale e projektit.

Përgjegjësia për përcaktimin e nevojave dhe hartimin e kriterëve është përgjegjësi e AK-së

Kjo çështje bëhet edhe më e qartë nga struktura e vet Rregullores për Prokurimin Publik.

Sipas nenit 10.1 të Rregullores, Njësia e Kërkesës është iniciuesja e aktivitetit të prokurimit dhe, ndër të tjera:

përgatit kërkesën për prokurim dhe vlerësimin formal të nevojave;

përgatit ose propozon detyrën projektuese dhe projektin;

përgatit specifikimet teknike;

përgatit Termat e Referencës;

përgatit Paramasën dhe Parallogarinë;

dhe duhet të sigurojë që specifikimet dhe projekti janë hartuar në përputhje me nenin 28 të LPP-së dhe nenin 19 të Rregullores.

Pra, zinxhiri ligjor është i qartë:

NJËSIA E KËRKESËS → përcakton nevojën → harton projektin → harton paramasën → harton specifikimet.

OE nuk ka marrë pjesë në këtë proces.

OE nuk ka përcaktuar kufijtë numerikë të kriterëve.

OE nuk ka hartuar analizat apo vlerësimet eventuale teknike mbi të cilat është bazuar Njësia e Kërkesës.

Prandaj, kur OE kundërshton një kriter dhe kërkon që të identifikohet baza konkrete teknike e tij, nuk mund t'i kërkohet OE-së që të rindërtojë përmes një ekspertize private procesin teknik që është dashur të bëhet gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit.

Një element tjetër me rëndësi, i cili duhet të merret parasysh në vlerësimin e bazueshmërisë së kriterëve dhe parametrave teknikë të këtij aktiviteti të prokurimit, është detyrimi i përcaktuar në nenin 19.16 të Rregullores për Prokurimin Publik.

Sipas kësaj dispozite, ZKA duhet të emërojë personin ose ekipin e Njesisë Kërkuese, me shkathtësi dhe përvojë të duhur, për hartimin e specifikimeve teknike. Personi apo ekipi i tillë, së bashku me specifikimet teknike, duhet të plotësojë dhe dorëzojë edhe Deklaratë nën Betim, sipas formularit standard të aprovuar nga KRPP.

Përmes kësaj Deklarate nën Betim, personi apo ekipi përgjegjës merr përgjegjësi se specifikimet teknike: janë në përputhje me qëllimin e prokurimit; janë të orientuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar;

nuk janë përgatitur në mënyrë që të favorizojnë apo diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomikë; dhe

nuk përmbajnë referenca të pajustificuara që do të orientonin kërkesën drejt një artikulli, burimi, procesi, lloji, origjine apo prodhimi të veçantë.

Kjo dispozitë është me rëndësi të drejtpërdrejtë për pretendimet e ngritura nga OE në këtë procedurë.

Nëse Njësia Kërkuese, përmes një Deklarate nën Betim, ka marrë përgjegjësi se dokumentacioni teknik është hartuar në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe pa kufizime diskriminuese, atëherë duhet të ekzistojë edhe një bazë konkrete, objektive dhe e verifikueshme mbi të cilën janë përcaktuar parametrat teknikë që janë kontestuar nga OE.

Në këtë rast nuk kemi të bëjmë vetëm me kërkesa të përgjithshme për posedimin e pajisjeve.

AK ka përcaktuar një numër të konsiderueshëm parametrash shumë specifike, përfshirë kufij minimalë dhe maksimalë të peshës, kapacitete, teknologji të caktuara, sisteme të veçanta dhe kërkesa të tjera teknike.

Pikërisht për këtë arsye OE ka kërkuar që AK të tregojë, për secilin kriter të kontestuar:

POZICIONIN E PARAMASËS → SASINË → NEVOJËN TEKNIKE → KRITERIN → PARAMETRIN KONKRET.

Kjo kërkesë bëhet edhe më relevante duke marrë parasysh ekzistencën e Deklaratës nën Betim të paraparë me nenin 19.16.

Nëse personi apo ekipi përgjegjës ka deklaruar nën betim se specifikimet janë të përshtatshme për qëllimin e kontratës dhe nuk kufizojnë në mënyrë të pajustificuar qasjen e operatorëve ekonomikë, atëherë AK duhet të jetë në gjendje që, kur një kërkesë konkrete kundërshtohet, të identifikojë bazën teknike mbi të cilën ajo është vendosur.

Nuk konsiderojmë të mjaftueshme që AK, pas ngritjes së pretendimeve konkrete, të përgjigjet vetëm se:

“kriteret janë të ndërlidhura me objektin e kontratës dhe me proceset e realizimit të punimeve.”

Kjo përgjigje nuk demonstroi se pse është zgjedhur pikërisht pesha, kapaciteti, teknologjia apo kufiri numerik i përcaktuar në Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, ekzistenca e Deklaratës nën Betim e përforcon argumentin se barra fillestare për hartimin dhe arsyetimin e dokumentacionit teknik i takon Autoritetit Kontraktues dhe Njësisë Kërkuese, e jo Operatorit Ekonomik.

Edhe Departamenti i Prokurimit ka përgjegjësi aktive lidhur me kufizimet në konkurrencë sipas nenit 11.3 të Rregullores, Zyrtari i Prokurimit ka përgjegjësi që, për atë që është e mundur, të sigurojë se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë dhe, në bashkëpunim me Njësinë e Kërkesës, të koordinojë projektet, specifikimet, Paramasën dhe Parallogarinë.

Kjo dispozitë është me rëndësi të drejtpërdrejtë.

Rregullorja i vendos vetë AK-së detyrim aktiv që gjatë përgatitjes së aktivitetit të verifikojë që specifikimet nuk krijojnë kufizime të panevojshme.

Prandaj, pasi OE ka ngritur pretendime konkrete, AK nuk mund të mjaftohet me formulimin:

“OE nuk ka paraqitur të dhëna të tregut.”

Së pari duhet të jetë e mundur të kuptohet mbi çfarë baze është vendosur kriteri nga vetë AK.

Neni 28 i LPP-së kërkon qasje sa më të mirë dhe lejon formulimin sipas funksionit dhe performancës

Sipas nenit 28.2 të LPP-së, AK duhet t'i përpilojë specifikimet teknike në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe në mënyrë të drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomikë.

Prandaj, kërkesa e OE-së që kriteret, aty ku është e mundur, të përcaktohen sipas:

funksionit;

fuqisë;

kapacitetit;

produktivitetit;
kapacitetit bartës;
forcës së ngjeshjes;
saktësisë;
kompatibilitetit;
rezultatit teknik,

nuk është kërkesë për uljen e standardeve.

Është kërkesë që kriteri të matë aftësinë reale për realizimin e kontratës. Kjo është kërkuar qartë në Kërkesën për Rishqyrtim.

Mungesa e analizës së tregut nuk e zgjidh çështjen e proporcionalitetit AK i referohet mungesës së “të dhënave të tregut”.

Mirëpo, të dhënat e tregut do të ishin veçanërisht relevante nëse pretendimi ynë do të ishte:

“këtë kriter e plotëson vetëm një prodhues”

ose:

“kriteri është hartuar posaçërisht për operatorin X”.

Ky nuk është thelbi i pretendimit tonë.

Pretendimi ynë është:

“Nga cili element i projektit buron ky kriter dhe pse pikërisht ky nivel është i nevojshëm?”

Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, provat kryesore janë:

projekti, paramasa, sasisë, specifikimet teknike, kushtet e realizimit dhe nevoja funksionale e kontratës.

Këto të dhëna janë pjesë e vet aktivitetit të prokurimit.

Prandaj mungesa e një studimi të tregut nga OE nuk e zëvendëson mungesën e lidhjes ndërmjet kriterit dhe projektit konkret.

Neni 7 i LPP-së nuk kufizohet vetëm në favorizimin e një operatori të identifikuar

Edhe arsyetimi se OE nuk ka dëshmuar favorizimin e një operatori të caktuar nuk e mbyll çështjen.

Neni 7.2 i LPP-së e ndalon AK-në që të zhvillojë ndonjë aspekt të aktivitetit në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën ose diskriminon në dëm apo në të mirë të operatorëve ekonomikë.

Prandaj nuk është e domosdoshme të identifikohet një përfitues konkret.

Një kriter mund të mos jetë hartuar për kompaninë X dhe përsëri të jetë më kufizues se sa kërkon nevoja reale e kontratës.

PRETENDIMET E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM NUK KANË MARRË PËRGJIGJE MERITORE

Për qëllim të kësaj ankese nuk konsiderojmë të nevojshme të përsërisim në tërësi të gjitha pretendimet paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim.

Ato tashmë janë paraqitur në mënyrë të detajuar për secilin kriter dhe janë pjesë e dokumentacionit të kësaj procedure.

Çështja kryesore e kësaj ankese është se përkundër konkretizimit të pretendimeve, AK nuk ka dhënë përgjigje meritore ndaj tyre.

Në Kërkesën për Rishqyrtim është kërkuar për secilin kriter:

pozicioni i paramasës;

sasia;

baza teknike;

arsyeja e kufirit minimal apo maksimal;

pranimi ose jo i ekuivalencës;

proporcionaliteti i kërkesës.

Ndërsa AK është përgjigjur kryesisht se kriteret:

“janë të ndërlidhura me objektin e kontratës dhe me proceset e realizimit të punimeve”

dhe se OE nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për të dëshmuar të kundërtën.

Ky arsyetim nuk i përgjigjet pyetjes konkrete.

“Pajisja lidhet me punimet” nuk është përgjigje ndaj “pse ky parametër?”

Ky dallim është thelbësor.

OE nuk ka pretenduar se pajisjet nuk përdoren fare në punime rrugore.

Pretendimi ka qenë:

pse pikërisht ky nivel, kjo peshë, ky kapacitet apo kjo teknologji është domosdoshmëri për këtë projekt?

Në vetë Kërkesën për Rishqyrtim është sqaruar se nuk është e njëjta gjë të thuhet:

“kjo pajisje mund të përdoret për këtë lloj pune”

dhe:

“pozicioni konkret X, me sasinë Y, kërkon domosdoshmërisht këtë pajisje me parametrin e përcaktuar.”

Ky është pikërisht dallimi që vendimi i AK-së nuk e ka trajtuar.

Pretendimet e OE-së kanë qenë konkrete dhe të verifikueshme

OE nuk ka përdorur vetëm formulimin:

“kriteri është joproporcional”.

Është kërkuar nga AK që të demonstrojë:

POZICIONI → SASIA → NEVOJA TEKNIKE → KRITERI → PARAMETRI.

Nëse baza ekziston, ajo duhet të jetë e verifikueshme në dokumentacionin e projektit.

Nëse një kriter është përcaktuar për shkak të:

një sasi konkrete;

një thellësie;

një gjerësie;

një produktiviteti;

kushteve specifike të trasesë;

afatit të realizimit;

apo rezultatit teknik,

kjo duhet të mund të identifikohet.

Pretendimi ynë është më themelor:

kriteri duhet të ketë një bazë objektive dhe të verifikueshme.

Nëse ajo bazë nuk identifikohet edhe pasi kriteri është kundërshtuar konkretisht, nuk mjafton që AK të deklarojë vetëm se “kriteri është i lidhur me kontratën”.

PËRGJEGJËSIA LIGJORE E AK-SË NË HARTIMIN E DOKUMENTACIONIT

Nga dispozitat e LPP-së dhe Rregullores krijohet një zinxhir i qartë përgjegjësie:

Njësia e Kërkesës përcakton nevojën → harton projektin → paramasën → specifikimet → Prokurimi koordinon dhe kontrollon dokumentacionin → kriteret duhet të jenë të nevojshme, relevante dhe proporcionale.

Neni 10.1 i Rregullores ia cakton Njesisë së Kërkesës përgjegjësinë për nevojën, projektin, specifikimet dhe paramasën.

Neni 11.3 i Rregullores i jep Zyrtarit të Prokurimit detyrën që, për aq sa është e mundur, të sigurojë se në specifikimet teknike nuk ka kufizime në konkurrencë.

Neni 28 i LPP-së kërkon qasje sa më të mirë për OE-të dhe ndalon specifikimet favorizuese ose diskriminuese.

Neni 51 kërkon që kriteret të jenë të nevojshme, drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale.

Prandaj nuk mund të krijohet situata ku:

AK harton kriterin → OE e kundërshton konkretisht → AK nuk tregon bazën e kriterit → dhe kërkon nga OE ekspertizë private për të provuar se kriteri nuk është i nevojshëm.

Kjo do ta përmbyste rendin logjik të përgjegjësive të përcaktuara nga legjislacioni i prokurimit.

OE duhet t'i konkretizojë pretendimet e tij.

Këtë e ka bërë.

Pas kësaj, pretendimet duhet të ballafaqohen me dokumentacionin e vet aktivitetit.

SQARIMET E DHËNA NGA AK DHE PAQARTËSITË E DOSJES SË TENDERIT

Një element tjetër i ngritur në Kërkesën për Rishqyrtim është fakti se, vetëm pas kërkesës për sqarim, AK ka qartësuar disa elemente materiale të kriterëve, duke përfshirë:

kuptimin e disa parametrave teknikë;

mënyrën e dëshmimit të aksesorëve;

interpretimin e kufijve të caktuar;
montimin e sistemeve të caktuara;
si dhe mënyrën e interpretimit të disa kërkesave për stafin.

Vetë fakti që këto elemente kanë kërkuar sqarim tregon se përmbajtja e tyre nuk ka qenë plotësisht e qartë nga formulimi fillestar.

Për këtë arsye është kërkuar që çështjet materiale të sqaruara pas publikimit të DT-së të reflektohen në dokumentacionin e tenderit dhe të trajtohen edhe afatet përkatëse për përgatitjen e ofertës.

Edhe kjo çështje nuk është trajtuar në mënyrë të mjaftueshme në vendimin për refuzim.

DISPOZITAT E SHKELURA

Bazuar në faktet dhe argumentet e paraqitura, konsiderojmë se AK nuk ka vepruar në përputhje të plotë me:

Nenin 7 të LPP-së, lidhur me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin dhe detyrimin që aktiviteti të mos zhvillohet në mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën;

Nenin 28 të LPP-së, lidhur me hartimin e specifikimeve në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe qasjen sa më të mirë për operatorët ekonomikë;

Nenin 51 të LPP-së, lidhur me detyrimin që kriteret të kufizohen vetëm në ato që janë të nevojshme dhe të jenë drejtpërdrejt relevante dhe proporcionale;

Nenin 53 të LPP-së, lidhur me sqarimet dhe informatat që ndikojnë në përgatitjen e ofertës;

Nenin 69 të LPP-së, lidhur me aftësinë teknike dhe profesionale;

Nenin 108/A paragrafët 6 dhe 9 të LPP-së, lidhur me shqyrtimin e Kërkesës për Rishqyrtim dhe detyrimin që refuzimi të jetë i arsyetuar;

si dhe dispozitat përkatëse të Rregullores për Prokurimin Publik, në veçanti nenet që përcaktojnë përgjegjësitë e Njesisë së Kërkesës dhe Zyrtarit të Prokurimit në hartimin dhe kontrollin e dokumentacionit të prokurimit.

KËRKESA PËRFUNDIMTARE

Duke u bazuar në të gjitha faktet, argumentet dhe dispozitat e paraqitura më sipër, kërkojmë që ankesa e OE SEFERI-CO SH.P.K. të aprovohet si e bazuar dhe:

Të anulohet Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës 27.08.2026, me të cilin është refuzuar Kërkesa për Rishqyrtim;

Të konstatohet se Kërkesa për Rishqyrtim nuk është trajtuar në mënyrë të mjaftueshme dhe meritore, duke marrë parasysh natyrën dhe numrin e pretendimeve të ngritura;

Të merren parasysh pretendimet e paraqitura në Kërkesën për Rishqyrtim si pjesë integrale e kësaj ankese, pa qenë e nevojshme përsëritja e tyre e plotë;

Të vlerësohet për secilin kriter të kontestuar nëse ai është:

i nevojshëm, drejtpërdrejt relevant dhe proporcional me lëndën e kontratës;

Të kërkohet që bazueshmëria e kriterëve të vlerësohet kundrejt:

projektit, paramasës, sasive, kushteve teknike dhe rezultateve që duhet të arrihen;

Për kriteret për të cilat nuk mund të identifikohet bazë konkrete objektive dhe teknike, të urdhërohet largimi ose riformulimi i tyre;

Kur i njëjti rezultat teknik mund të arrihet me pajisje standarde profesionale apo teknologji ekuivalente, kriteret të përcaktohen sipas funksionit dhe performancës, duke shmangur kufizimet e panevojshme numerike;

Të rishikohen kriteret për stafin në raport me kompleksitetin real të projektit;

Të korrigjohen në Dosjen e Tenderit çështjet materiale të cilat janë sqaruar vetëm përmes përgjigjes së datës 26.08.2026;

Si rezultat i korrigjimeve eventuale, të bëhet edhe zgjatja përkatëse e afatit për dorëzimin e ofertave.

IX. PËRFUNDIM

OE SEFERI-CO SH.P.K. nuk e konteston kompetencën e Autoritetit Kontraktues për të përcaktuar kapacitetet teknike dhe profesionale të nevojshme për realizimin e kontratës.

Kontestohet fakti se një numër i konsiderueshëm kriteresh janë përcaktuar me nivele dhe parametra shumë specifike, ndërsa pas kërkesave konkrete të OE-së nuk është demonstruar në mënyrë meritore pse pikërisht ato nivele janë të nevojshme dhe proporcionale me punimet konkrete të këtij aktiviteti. Kjo ka qenë edhe baza e Kërkesës për Rishqyrtim.

OE ka bërë atë që i takon palës ankuese: ka identifikuar kriterin, ka identifikuar elementin që kontestohet, ka kërkuar lidhjen e tij me projektin dhe ka propozuar alternativë funksionale.

Nuk mund të zhvendoset te OE përgjegjësia që, përmes ekspertizave private dhe analizave të tregut, të rindërtojë bazën teknike mbi të cilën AK është dashur t'i hartojë kriteret para publikimit të tenderit.

Përfundimisht, koha prej vetëm 5 orë e 41 minuta ndërmjet dorëzimit të Kërkesës për Rishqyrtim dhe publikimit të refuzimit, e kombinuar me arsyetimin e përgjithshëm dhe mungesën e ballafaqimit të pretendimeve me projektin dhe paramasën, përforcon pretendimin se Kërkesa për Rishqyrtim nuk është shqyrtuar në mënyrë meritore.

Për këto arsye kërkojmë që ankesa të aprovohet si e bazuar dhe aktiviteti të kthehet në fazën përkatëse për korrigjimin dhe rishqyrtimin e kriterëve në përputhje me LPP-në dhe Rregulloren për Prokurimin Publik.